



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI**

VENDIM

Nr. 72, datë 28.04.2021

**PËR
MIRATIMIN E RIEMËRIMIT TË ANËTARËVE TË KËSHILLIT MBIKËQYRËS DHE
ADMINISTRATORIT TË SHOQËRISË SË SIGURIMIT “ATLANTIK” SH.A.**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 22, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, nenit 21, të Ligjit nr. 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, si dhe Rregullores nr. 137, datë 21.12.2015 “Mbi procedurën, afatet dhe dokumentacionin e nevojshëm/shtesë për miratimin e emërimit dhe riemërimit të anëtarit të Këshillit të Administrimit/Mbikëqyrës, Administratorit/Anëtarit të Bordit të Drejtorëve të shoqërisë së sigurimit”, e ndryshuar, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

- 1. Miratimin e riemërimit të z. Luan Bregasi në pozicionin e kryetarit të Këshillit Mbikëqyrës dhe miratimin e riemërimit të z. Rrapo Çelaj dhe z. Aleksandër Muskaj në pozicionet e anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës të shoqërisë së sigurimit “Atlantik” sh.a.**
- 2. Miratimin e riemërimit të z. Dritan Çelaj, në pozicionin e Administratorit të shoqërisë së sigurimit “Atlantik” sh.a.**
- 3. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit, për njoftimin dhe ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.**

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR
Olsi ÇOKU**

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV
Ervin METE**